

METODOLOGJI

**MBI VLERËSIMIN E
PËRGJEGJSHMËRISË SË**

**PREMTIMEVE
ZGJEDHORE**

Shtator 2024

POLIFAKT.al

ALTAX

PËRDOMËRIA NGA PËRVOJA E ZGJUAR

METODOLOGJI

mbi vlerësimin e përgjegjshmërisë së premtimeve zgjedhore (e azhornuar)

Deklarimi përgjegjësive

Metodologjia është realizuar si pjesë e projektit "*Rritja e llogaridhënies financiare të premtimeve të partive politike përballë ekspertizës civile*" të mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SHBA në Tiranë.

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të ALTAX dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej përdoruesve, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e "Qendrës AL-TAX" si burim.



Shtator/ September 2024
TIRANË

www.altax.al
info@altax.al
Datë 25.09.2024
Tiranë, Shqipëri

POLIFAKT.

AL TAX
PËRSOJMËRIA NGA PËRVOJA E ZGJUAR

Synimi i Metodologjisë së azhornuar

Përditësimi i termave dhe përmbajtjes së metodologjisë aktuale për një analizë më të mirë sasiore ekonomike të premtimeve elektorale dhe manifesteve politike. Metodologjia e përditësuar synon ndërveprimin më të mirë të vlerësimeve financiare me premtimet duke përcaktuar nga të dhënat e katër zgjedhjeve të fundit dhe disa përcaktime mbi diapazonin e kostos financiare buxhetore të secilit prej premtimeve sipas ndarjes së sektorit ekonomik dhe atij qeveritar.

Duke ndërtuar një mekanizëm matës më të avancuar se në projektin e mëparshëm, synojmë të fokusojmë analizën në shpjegimin e raporteve duke i treguar publikut një prag real të realizueshmërisë së premtimeve, duke filluar nga buxheti i qeverisë dhe programi buxhetor afatmesëm dhe të gjitha dokumentet kryesore makroekonomike për periudhat e ardhshme.

ALTAX - Qendra Ekonomike dhe Fiskale Shqiptare është një qendër kërkimore dhe zhvilluese jofitimprurëse me bazë në Shqipëri. Ajo analizon politikën ekonomike dhe fiskale të brendshme dhe të jashtme shqiptare për të ofruar një burim të besueshëm ekspertize mbi faktorët politikë, ideologjikë, kulturorë, ekonomikë dhe historikë që ndikojnë në politikat shqiptare ndaj Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë. Bashkëpunimi me akademikët dhe ekspertët ndihmon në zgjerimin dhe krijimin e një audiencë gjithëpërfshirëse në ndihmë të rritjes së kapaciteteve fiskale në Shqipëri dhe Kosovë e më gjerë.

Ne analizojmë ekonominë, sistemin fiskal, llogaridhënien e politikanëve duke parë kryesisht nivelin kombëtar dhe rajonal të treguesve makro dhe mikro, të dhënat statistikore, tregun, buxhetin e qeverisë, të dhënat e tregut të punës dhe tendencat sektoriale.

Edhe pse janë qytetarët ata që përcaktojnë në fund drejtimin e ekonomisë dhe shoqërisë, qeveritë ndikojnë në të edhe nëpërmjet politikës fiskale dhe monetare.

Ne ofrojmë për donatorët, organizatat dhe palët e tjera analizën e duhur të temave që janë interesante edhe për parashikimet e ardhshme.

Në Think Tank-un tonë, ne mund të:

- Realizojmë një analizë paraprake mbi politikat ekonomike
- Përgatitim një model të ekspertizave dhe politikave
- Organizojmë studime dhe raporte bazuar mbi partnership me individë dhe organizata
- Përgatitim analizë tregu dhe faktorësh ndikuesë
- Analizojmë të gjitha të dhënat për reflektimin e duhur politik

Informacioni i kontaktit

Metodologjia gjendet online në [ALTAX](#) dhe [POLIFAKT](#)

Nëse keni kërkesa apo pyetje dërgojini tek info@altax.al

ALTAX - Albanian Economic and Fiscal Center is a non-profit research and development center based in Albania. It analyzes Albanian internal and external economic and fiscal policy to provide a reliable source of expertise on the political, ideological, cultural, economic and historical factors influencing Albanian policies towards the Western Balkans and beyond. Cooperation with academics and experts helps to expand and create a comprehensive audience to help increase fiscal capacities in Albania and Kosovo and beyond.

We analyze the economy, the fiscal system, the accountability of politicians looking mainly at the national and regional level of macro and micro indicators, statistical data, the market, the government budget, labor market data and sectoral trends.

Although it is the citizens who ultimately determine the direction of the economy and society, governments also influence it through fiscal and monetary policy.

We provide donors, organizations and other parties with the right analysis of topics that are also interesting for future forecasts.

At our Think Tank, we can:

- We carry out a preliminary analysis on economic policies
- Preparation of a model of expertise and policies
- We organize studies and reports based on partnerships with individuals and organizations
- Preparation of market analysis and influencing factors
- We analyze all data for proper political reflection

Contact information

Methodology can be read/download online në [ALTAX](#) and [POLIFAKT](#)

If you have requests or questions, send them to info@altax.al

Ndiqni ALTAX dhe Polifakt në mediat sociale, Web dhe në Aplikacionin tonë:



[FISKALISTI](#)

Ju jeni vendosur në fokusin tonë dhe ne jemi në vëmendjen tuaj duke krijuar së bashku!



[ALTAX - POLIFAKT](#)

Ne publikojmë dhe shpërndajmë informacione, analiza dhe studime në vijimësi.



[ALTAX](#)

Komunikoni përmes adresave të mediave sociale



[ALTAX](#)

Shikoni videot tona informative dhe edukuese



[ALTAX.AL](#)

Lexoni analiza dhe studime unike ekonomike/fiskale



[POLIFAKT.AL](#)

Kuptoni sa janë mbajtur premtimet e politikës



[App Store](#)
[Google Play](#)

Shkarkoni Aplikacionin t'ju vijmë direkt në cel.

Një marëdhënie mbi të përbashkëtat që na bashkojnë në jetën e përditshme.

HYRJE	Faqe 8
Zbatimi i metodologjisë	Faqe 9
METODA E ANALIZËS	Faqe 10
1 Çfarë është kostoja e premtimeve zgjedhore?	Faqe 11
2 Verifikimi i përgjegjshmërisë sipas llojeve të premtimeve/zotimeve	Faqe 11
3 Funkcionet e programeve politike zgjedhore	Faqe 13
4 Përmbajtja e programeve zgjedhore	Faqe 14
5 Si duhet t'i masim premtimet e politikës para dhe gjatë fushatës zgjedhore?	Faqe 15
6 Analiza e fizibilitetit të premtimeve zgjedhore	Faqe 16
7 Analiza e programeve politike për antikorrupsionin	Faqe 18
8 Analiza e Kapacitetit politik	Faqe 19
RËNDËSIA E DEBATIT POLITIK MBI PREMTIMET BAZUAR TE KOSTOJA E TYRE	Faqe 23

HYRJE

Programet e partive politike komunikojnë vlerat dhe shqetësimet e një partie politike, si dhe idetë, politikat që ajo mbron dhe kërkesat që partia dëshiron të zbatojë. Programet e partive luajnë një rol kyç në sistemet politike demokratike pasi ato formësojnë vendimet e votuesve gjatë zgjedhjeve, shërbejnë si pika referimi për të vlerësuar performancën e partive politike, përcaktojnë axhendat e politikave dhe propozojnë zgjidhje për të adresuar sfidat shoqërore. Për më tepër, ato strukturojnë ndërveprimet midis forcave politike dhe mund të formësojnë ndjeshëm politikën e qeverisë (Van der Does dhe Statsch, 2016).

Dekadën e fundit, kriza e lidërshiptit si pjesë shoqëruese e krizës politike të vazhdueshme në ambjentin politik shqiptar ka përforcuar rëndësinë e analizës së premtimeve zgjedhore si nga këndvështrimi sasior, por edhe cilësor. Ndërkohë, vetëm ky këndvështrim nuk e evidenton dot inflacionin e premtimeve zgjedhore në fushatat politike të partive në Shqipëri, i cili është mesatarisht në nivelin deri në 60% i papërbushur apo i papërfshirë në programet qeverisëse në rastet kur partitë kanë fituar zgjedhjet dhe kanë marrë mandatin për të qeverisur.

Kultura demokratike dhe kultivimi i një lidërshipti të bazuar te përgjegjshmëria, nëpërmjet transparencës dhe llogaridhënies lidhur me nivelin e përbushjes së premtimeve zgjedhore duhet që

pas mbi 3 dekadash bashkëegzistence me rendin politik bazuar te parimet liberale të qeverisjes së hapur dhe gjithpërfshirëse

të prodhojë dallime të rëndësishme në funksionalizimin e qeverisjes së përgjegjshme bazuar në këto parime.

Përbushja e [zotimeve zgjedhore](#) është në qendër të llogaridhënies demokratike.

Nëse partitë u përgjigjen kërkesave të shoqërisë, duhet të ketë një nivel të konsiderueshëm kongruence midis politikave të tyre në qeverisje dhe premtimeve që gjenden në programet e tyre zgjedhore.

Detyrat dhe organizimi për zbatimin e metodologjisë

Që një OJQ të kryejë këtë funksion, është e rëndësishme të kuptojë jo vetëm aspektet teknike të koston, por edhe të ketë një kuptim të fushave kryesore të politikave, si shëndetësia dhe arsimi. Kjo kërkon personel me ekspertizën e duhur teknike dhe specializimet përkatëse.

Një OJQ gjithashtu do të duhet të ketë besueshmëri publike në mënyrë që gjetjet e saj të barten nga media dhe të pranohen nga partitë politike. Qasja në financim është gjithashtu e rëndësishme. ALTAX me bazë në Shqipëri e kryen analizën bazuar te burimet që ka organizuar për zbatimin me kapacitet të plotë të projektit dhe me një ndihmë financiare nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë.

Në vitin 2024, burimet e nevojshme që ka ALTAX përfshinin afërsisht 9 individë, në nivele të ndryshme aftësish dhe përpjekjesh dhe marëdhënieje pune dhe bashkëpunimi. Këtu përfshiheshin punonjës për mbledhje dhe përpunim informacioni, ekspertë të financave, si dhe ekspertë të sektorëve në fusha të tilla, si: politikat sociale, infrastruktura, energjia, arsimi dhe shëndetësia.

METODA E ANALIZËS

Analiza jonë përfshin numërimin e premtimeve specifike në programet e fushatës së partive dhe më pas përcaktimin se sa prej tyre janë zbatuar nga partia që është zgjedhur në detyrë në 5 zgjedhjet e fundit.

Po kështu, duke u nisur nga pjesa sasiore e vlerësuar në vlerë sipas tipit të premtimit e krahasojmë me peshën që mban në buxhetin e shtetit duke konfirmuar ose jo nëse është e arritshme duke u nisur nga pesha që mban në buxhet secili nga premtimet sektoriale në 15 vitet e fundit.

Me këtë lloj analize, ekziston rreziku që interpretimi subjektiv i asaj që përbën një premtim dhe çfarë veprimi kërkohet për të deklaruar se një premtim është mbajtur mund të dëmtojë besueshmërinë dhe vlefshmërinë e të dhënave. Prandaj është e rëndësishme të sqarojmë se ku i gjejmë premtimet zgjedhore dhe çfarë kualifikohet si premtim.

Burimet dokumentare nga të cilat nxirren premtimet janë programet e partive që dalin gjatë fushatave zgjedhore.

Ka një sërë dokumentesh që përmbajnë premtime partiake: fjalime të liderëve të partisë, pamflete dhe fletëpalosje partiake, reklama në gazeta, fjalime në kuvende partiake, të cilat nuk janë gjithmonë të krahasueshme ose përfaqësuese të lartë të politikës zyrtare të partisë.

Përdorimi i programeve të partisë ka avantazhin e sigurimit të një organi të mirëpërcaktuar dhe koherent të dokumenteve të partisë të sanksionuara zyrtarisht.

Ai gjithashtu ka disavantazhin e injorimit të premtimeve zgjedhore që nuk janë në programin e partisë

Përveç strukturës institucionale në të cilën bëhen premtimet, ne shqyrtojmë nëse karakteristikat e vetë premtimeve ndikojnë në gjasat e tyre për t'u përmbushur.

Duke qenë të gjitha gjërat njësoj, duke pasur parasysh rritjen e qeverive të mëdha në përgjithësi, pritet që premtimet për të ruajtur status-quo-në janë më të lehta për t'u mbajtur sesa premtimet për të ndryshuar politikën.

Gjithashtu pritet që zotimet për të rritur taksat mund të jenë të vështira për t'u mbajtur, duke pasur parasysh jopopullaritetin e taksave në përgjithësi.

Çfarë është kostoja e premtimeve zgjedhore?

Një përkufizim praktik dhe i zbatueshëm i termit "kosto e premtimeve" është "vlera monetare e burimeve (njerëzore, fizike dhe financiare) të konsumuara për të arritur një qëllim të caktuar.

Nuk është e pazakontë që partitë opozitare të bëjnë premtime fushate në opozitë, të cilat ata e kuptojnë se janë të paqëndrueshme kur formojnë qeverinë. Ofrimi i mundësisë së të gjitha palëve për t'u kushtuar platformave të tyre të politikave përpara zgjedhjeve mund të çojë në politika më të mira publike.

Kjo praktikë u mundëson partive të zhvillojnë platforma më të qarta dhe më të realizueshme për zgjedhjet. Kur këto parti formojnë qeverinë, ato janë gjithashtu në një pozicion më të mirë për të zbatuar politika më praktike që në fillim.

Premtimet elektorale që nuk llogariten siç duhet mund të jenë gjithashtu një gabim i kushtueshëm. Qeveritë mund të pësojnë dëmtim të reputacionit nga rritja e çmimit për një premtim elektoral pas zgjedhjeve, por mbi të gjitha qytetarët që paguajnë taksat, pasi presioni për të vazhduar me një premtim elektoral pavarësisht një projekcioni të modifikuar të koston mund të rezultojë në mbishpenzime të konsiderueshme.

Verifikimi i përgjegjshmërisë sipas llojeve të premtimeve/zotimeve

Zgjedhjet kanë rëndësi për ekonominë dhe financat publike, por ekonomia dhe buxheti i shtetit ka të ngjarë të jenë veçanërisht e harmonizuara me ciklin aktual zgjedhor duke pasur parasysh trajektoren e paqëndrueshme fiskale.

Janë dy lloje premtimesh që trajtohen sipas metodologjisë.

1. Premtimet që përfshihen në programe qeverisëse ndahen në "të përmbushura", "të papërmbushura" dhe "të përmbushura pjesërisht".

Nëse premtimet zgjedhore janë përmbushur, vlerësohet bazuar në analizat e përmbajtjes së njoftimeve për shtyp të qeverisë, ligjeve dhe rregulloreve, fjalimeve të fronit dhe fjalimeve buxhetore, raporteve vjetore dhe planeve buxhetore nga ministritë dhe agjencitë qeveritare.

Një premtim programor vlerësohet "pjesërisht i përmbushur" kur veprimi përkatës është një kompromis ose veprimi është përfunduar, por nuk shkon aq larg sa është premtuar.

Për shembull, premtimi i për "legalizimin e shtëpive" klasifikohet si i përmbushur pjesërisht sepse disa, por jo të gjitha janë kryer.

Premtimi klasifikohet si "i papërmbushur" kur nuk pasohet nga një veprim i qeverisë apo nuk është e mundur të realizohet një premtim i tillë për arsye kohe apo fondesh.

Një lloj i veçantë i premtimeve të përjashtuara janë premtimet e përgjithshme/relative, të përcaktuara si premtime ku vetëm rezultati është i matshëm dhe të cilat nuk specifikojnë se çfarë do të bëjë partia për të arritur atë rezultat (p.sh. nëse zgjidhemi, ne do të ulim papunësinë).

Shumica e premtimeve të përgjithshme qartazi nuk i plotësojnë kriteret tona të testueshmërisë.

Prandaj, ato përjashtohen nga analiza, përveç nëse ata specifikojnë veprimin që do të ndërmerret një qeveri për të arritur rezultatin e deklaruar, në të cilin rast, ato konsiderohen si premtime "jo të përgjithshme".

2. Një tjetër klasifikim që trajton metodologjia është edhe premtimet që bëjnë partitë politike, në formën e platformës parazgjedhore, ku prezantohen zotime të natyrave të ndryshme.

Tabela 1 klasifikon zotimet e partive politike sipas faktit nëse ato premtojnë të mbajnë status-quo-në apo të ndryshojnë politikën.

Tab 1.					
Tipi Premtimit	Ulje	Rritje	Mbeshtetje	Ndryshim	Tjetër
Premtime buxhetore					
Premtime Fiskale					
Premtime Ekonomike					
Ndryshim politike					

Këto premtime klasifikohen si dhe deri më sot, në "të vërteta", në "pjesërisht e pavërtetë" dhe në "të pavërtetë"

Premtimet për të ndryshuar politikën ndahen më tej në premtime që propozojnë "uljen e shpenzimeve qeveritare" (ose rritjen e taksave), "zgjerimin e shpenzimeve qeveritare", "uljen e taksave" dhe për të bërë ndryshime politikash që nuk lidhen me shpenzimet dhe taksat qeveritare ("ndryshim tjetër").

Në përgjithësi, vetëm 12% e premtimeve kanë të bëjnë me ruajtjen e status-quo-së, me 88% të mbetur mbrojnë një lloj ndryshimi politikash.

Premtimet për të ndryshuar politikën kanë të bëjnë kryesisht me ndryshime që nuk ndikojnë në shpenzimet dhe taksat. Premtimet për të zgjeruar shpenzimet e buxhetit janë shumë më të shpeshta se premtimet për të shkurtuar shpenzimet e qeverisë.

Ne e fillojmë analizën që bazohet te metodologjia aktuale duke trajtuar pyetjen kryesore përshkruese të ngritur nga analizat e zgjedhjeve të kaluara:

- Në çfarë mase qeveritë i përmbushin zotimet zgjedhore të partive?

Në përgjigje të kësaj pyetje mund të thuhet se

Ne gjithashtu shqyrtojmë nëse ka një lidhje më të fortë programi me politikën për partitë qeverisëse sesa për partitë opozitare.

Funksionet e programeve politike zgjedhore

Programet politike kanë dy lloje kryesore funksionesh: përmirësimin e suksesit zgjedhor dhe menaxhimin e marrëdhënieve si brenda partisë ashtu edhe jashtë partisë me forcat e tjera politike.

Manifestet zgjedhore janë krijuar për të përmirësuar performancën e partisë gjatë zgjedhjeve dhe përmbajtja e tyre është rezultat i një llogaritjeje që synon të fitojë vota.

Ne i referohemi një partie si një "parti qeverisëse" nëse ka postin ekzekutiv pas zgjedhjeve dhe një "parti opozitare" nëse nuk e arriti dot të jetë pjesë e mandatit qeverisës, pavarësisht nëse partia ishte në pushtet gjatë fushatës zgjedhore në të cilën ajo bëri zotimin.

Përbushja e zotimeve të partive opozitare mund të shpjegohet të paktën pjesërisht me faktin se partitë qeverisëse bëjnë të njëjtat ose premtime të ngjashme për disa çështje, ose se premtimet kanë të bëjnë me politika të pakontestueshme që do të zbatonte çdo qeveri.

Partitë qeverisëse gjithashtu mund të miratojnë dhe të marrin kredibilitet për politikën popullore të propozuara nga kundërshtarët e tyre.

Në këtë sfond, partia qeverisëse mund të shpallë premtime relativisht modeste për shpenzime në zgjedhje deri tani.

Megjithatë, shkalla e premtimeve, mënyra se si financohen dhe sa do të kushtonin, mund të zbehet nga ndryshime të tjera në perspektivën e financave publike, mbi të cilat asnjëra palë nuk ka kontroll.

Programet zgjedhore në përgjithësi mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh politike, të përshkruara në mënyrë strategjike, të interpretuara dhe të theksuara nga partia për të shprehur pozicionin e saj dallues ideologjik mbi të cilin një parti konkurren në zgjedhje.

Në këto linja, *Eder, Jenny dhe Müller (2016)* bëjnë dallimin midis tre funksioneve që mund të shërbejnë një program politik:

- të sigurojë një pozicion partiak;
- të vendosë supremaci mbi pozicionet e tjera politike të së njëjtës parti dhe në këtë mënyrë të përmirësojë fushatën e partisë;
- të informojë votuesit

Përbajtja e programeve zgjedhore

Përbajtja e programeve/manifesteve politike mund të ndryshojë në varësi të theksimit, llojit dhe formulimit të parimeve dhe politikave të ndryshme.

Për shembull, jo të gjitha deklaratat në një manifest mund të kenë të njëjtën vlerë për partinë politike. Disa deklarata mund të përfaqësojnë angazhime të forta ndaj një politike të caktuar, ndërsa të tjerat mund të jenë në natyrë retorike.

Ky peshim i diferencuar nënkupton që jo të gjitha përmbajtjet në një program politik komunikojnë domosdoshmërisht një pozicion politik dhe se shpesh angazhimet politike plotësohen me lloje të tjera tekstesh (*Van der Does dhe Statsch, 2016*).

Këto tekste plotësuese mund të jenë përshkrimi i arritjeve të partisë, pasqyrave financiare, informacion i detajuar i kandidatëve të partisë, e kështu me radhë.

Marrja në konsideratë e këtyre faktorëve gjatë hulumtimit të programeve partiake do të ofrojë një pamje më të plotë të origjinës, natyrës dhe angazhimit të çdo zotimi ose përshkrimi politikash të bërë në to.

Si duhet t'i masim premtimet e politikës para dhe gjatë fushatës zgjedhore?

Premtimet e platformave partiake, si rregull i ofrohen elektoratit si opsione politikash që duhet të bazohen në vlerësime të besueshme të kostove.

Mirëpo, në gjithë zgjedhjet e fundit në Shqipëri procesi i kostimit të premtimeve është lënë mënjanë duke arritur në premtime që nuk kanë nevojë të analizohen, pasi dukshëm janë të pabesueshme edhe për qytetarin që nuk zotëron një dije ekonomike të thelluar.

Ajo që ne këmbëngulim prej të paktë 5 vitet e fundit është se procesi i vlerësimit të kostos së premtimeve politike mund të funksionojë në mënyrë efektive, por së pari duhet të kihet besim tek institucioni që kryen analizën e kostos, pasi në vetvete këto analiza në botë kryhen nga institute të specializuara, dhe jo nga qeveria apo nga stafe politike opozitare.

Ajo që vlen për llogaritjen e kostove të premtimeve është domosdoshmëria për të sqaruar votuesin mbi nivelin e inflacionit të premtimeve duke u bazuar te argumenti fiskal dhe ekonomik.

Prezantimi i kostove të platformave elektorale të partive politike mund të nxisë gjithashtu krijimin e pozicioneve praktike ndërmjet partive politike konkurruese.

Kjo mënyrë e re në Shqipëri për tu bërë pjesë e ballafaqimit politik nëpërmjet analizës ekonomike gjithashtu ndihmon fushën e lojës midis partive opozitare dhe qeverisë, duke kontribuar në një kontekst më të fortë demokratik.

Analiza e fizibilitetit të premtimeve zgjedhore

Analiza e fizibilitetit të premtimeve politike përdoret për të parashikuar rezultatin e mundshëm të një zgjidhjeje të propozuar për një problem të politikave nëpërmjet ekzaminimit të aktorëve, ngjarjeve dhe mjedisit të përfshirë në të gjitha fazat e procesit të politikëbërjes dhe mund të shërbejë si një kriter vlerësues në zgjedhjen midis alternativave të politikave.

Fizibiliteti politik¹ është një masë se sa mirë do të pranohet një zgjidhje për një problem politikash nga një grup vendimmarrësish dhe publiku i gjerë. Që një politikë të miratohet dhe zbatohet, ajo duhet të jetë politikisht e pranueshme, ose e realizueshme.

Mungesa e fizibilitetit politik të alternativës politike shpesh mund t'i atribuohet mungesës së mbështetjes politike ose rezultatit të polemikave që mund të rrethojnë çështjen që politika kërkon të trajtojë.

Përndryshe, një alternativë e realizueshme politikisht është ajo që ka probabilitetin më të madh për "të marrë shtytje dhe mbështetje të mjaftueshme politike për t'u zbatuar" duke pasur parasysh ndonjë kufizim specifik.

Kur analiza e politikave gjeneron alternativa politike, rreziqet dhe kostot politike që lidhen me secilën mund të jenë kritere të rëndësishme për të vendosur midis alternativave. Një alternativë e mirë politike kërkon një masë të caktuar të fizibilitetit politik, ose zbatimin e politikës do të jetë i pamundur.

Megjithatë, është e rëndësishme të kihet parasysh se vetëm fizibiliteti nuk e bën një politikë "të mirë". Ekzaminimi i të gjitha kriterëve është i nevojshëm për zbatimin e politikës së përgjegjshme shoqërore.

Hapi i parë për analistin e politikave është të identifikohet dimensionin që përfshin problemin që adreson premtimi politik. Ky dimension përmban një hapësirë të gjerë politikash, siç është politika shëndetësore ose politika arsimore, fiskale etj.. Më pas, analisti përcakton fushën specifike të çështjes së politikës.

¹ Fizibiliteti është "gjendja ose shkalla e realizimit të lehtë ose të përshtatshme". P.sh. një pyetje që përshkruan analizën e fizibilitetit është: Në këtë klimë politike, a mund të për, bushet premtimi që jepet nga partia?

Në përputhje me shembullin, fusha më e ngushtë e çështjeve të politikave shëndetësore është shërbimi cilësor.

Pasi të bëhet kjo, analisti mund të fillojë të identifikojë faktorët e përfshirë në këtë politikë. Brenda këtij hapi analizohen faktorë të tjerë, që duhen përfshirë, të tilla si: niveli i ndërgjegjësimit publik për politikën e propozuar, dinamika e krijuar nga koha e propozimit të politikës dhe shqetësimet dhe modelet e votimit të demografive të ndryshme.

Hapi i dytë, përshkruan skenarët politikë që rrethojnë politikën e propozuar. Identifikimi i palëve/grupeve kryesore të interesit (faktorët) është një moment me peshë për të shqyrtuar një politikë të propozuar/premtuar.

Faktorët kryesorë mund të jenë përveç palëve politike dhe ekonomike edhe organizata ose aleanca civile të qytetarëve. Të tillë faktorë dallohen nga pozicionet e tyre politike.

Gjithsesi duhet mbajtur çdo herë që analizohen këta faktorë se çfarë i motivon sjelljet e tyre ndaj politikës së premtuar. (motive politike, motive ideologjike, motive financiare, apo motive të tjera)

Një arsye shumë e rëndësishme është identifikimi i burimet që kanë në dispozicion për ta realizuar premtimin që bëjnë partitë politike. Analiza e burimeve të identifikuara nga ekspertët/analistët duhet të përfshijë burimet fizike, financiare dhe njerëzore.

E gjithë kjo vlen për të mbledhur informacionin e nevojshëm duke konsideruar si ndikimin e faktorëve brenda klimës politike, por po ashtu edhe përfshirjen e gjithë të dhënave fiskale dhe financiare të shtetit për të shërbyer në analizën krahasuese mes premtimeve dhe mundësive për realizimin e tyre.

Sqarimi për burimet që mundësojnë përmbushjen e premtimit

Përmbushja e premtimeve kushtëzohet edhe nga disponueshmëria e fondeve. Një premtim me një kosto të kufizuar është padyshim më i lehtë për t'u mbajtur sesa një premtim me implikime të mëdha buxhetore. P.sh., premtimet për politika reformuese rregullatore kanë implikime buxhetore më të kufizuara sesa politikat rishpërndarëse të fondeve të buxhetit të shtetit. Ky kufizim buxhetor është veçanërisht i fortë sot sepse ngadalësimi ekonomik ndikon në objektivat kryesore buxhetore, të cilat pavarësisht kush do ti fitojë zgjedhjet politike janë të detyruar të sigurojnë balancë të llogarive të buxhetit të shtetit.

Hapi i tretë vjen në formën e draftimit të vlerësimit të niveleve të pranueshme sipas përpunimit të të dhënave duke arritur në një moment të analizës, ku faktet e krahasuara me premtimin politik janë në mbështetje/kundërshtim të politikës së propozuar.

Kjo përfshin identifikimin e fushave të mundshme të konsensusit dhe konfliktit politik, duke përcaktuar në thelb se çfarë është e nevojshme që politika të fitojë mbështetjen për miratim dhe zbatim.

Në këtë moment fundor të analizës vjen sfida e ballafaqimit të politikave ku duhet të merret parasysh se çfarë lloj kombinimesh të faktorëve do të jenë të nevojshme për të marrë vlerësimin përkatës secili premtim politik.

Në këtë rast, nisur nga specifika e vijimësisë së qeverisjes prej disa mandatesh në dekadën e fundit duhet të analizojmë edhe premtimet e frymëzuara nga iniciativat që tashmë janë në rendin e ditës para zgjedhjeve dhe që kanë padyshim më shumë gjasa për t'u mbajtur sepse shpesh janë vijimësi të politikave të miratuara në mandatet e mëparshme.

Në të vërtetë, një premtim, funksionalizimi i të cilit tashmë është avancuar ndjeshëm në praktikë, edhe pse konsiderohet si i arritshëm për përmbushje duhet të sqarohet me detaje për sa lidhet me ballafaqimin e afateve dhe burimeve shtesë që mund të jenë alokuar.

Analiza e programeve politike për antikorrupsionin

A merret metodologjia me analizimin e programeve partiake për tema të tilla, si: antikorrupsioni, transparenca apo (keq)përdorimi i fondeve publike?

Analiza e masave kundër korrupsionit të përfshira në programet politike mund të kryhet në të paktën dy mënyra:

- së pari, duke parë theksin, pozicionin dhe deklaratimet e hapura të partisë politike për këtë çështje, dhe
- së dyti, se si partitë politike ndërtojnë kuptime specifike të korrupsionit dhe kundër korrupsionit dhe t'i përdorin këto kuptime si instrumente për të çuar përpara objektivat e tyre në diskursin politik.

Fokusi i ngushtë i fushatës zgjedhore në premtimet për shpenzime në dukje të vogla nga partitë kryesore politike rrezikon të shkaktojë pasiguritë më të mëdha ekonomike me të cilat qeveria e ardhshme mund të ketë nevojë të përballet.

[Praktikat e mira](#) për anti-korrupsionin në programet e partive varen shumë nga partia politike dhe konteksti ekonomik e social demokratik. Sidoqoftë, ka rekomandime dhe masa për të siguruar angazhimin e partive me llogaridhënie dhe transparencë të brendshme, veçanërisht në lidhje me financimin e partive.

Në këtë drejtim disa aspekte kryesore që metodologjia merr parasysh për analizën e programeve të partive politike janë qasja e:

- programit politik,
- konteksti në të cilin është krijuar programi,
- lidhshipi drejtues dhe strukturimi politik, dhe
- përmbajtja e programit politik.

Metodologjia kërkimore që përdoret për të analizuar programet e partive në kuptim të një fushe të caktuar politike, synon analizën e *përmbajtjes* dhe analizën e *perspektivës*.

Analiza e përmbajtjes përcakton sasinë e modeleve brenda programit në një mënyrë objektive, të përsëritshme dhe sistematike. Analiza synon pasazhe tekstuale për të identifikuar pozicionin e partisë politike për një çështje të caktuar, si dhe theksin relativ që partia i jep asaj.

Analiza e perspektivës që paraqet programi/platforma hyn te analizimi metodologjik cilësor, që ofron një kornizë për një kuptim më të pasur të mënyrës sesi ndërtohet dhe interpretohet kuptimi në debatin ekonomik dhe politik lidhur me tendencën dhe ardhmërinë.

Analiza e Kapacitetit politik

Disa analiza në vijimësi që ne kemi bërë² na tregojnë se cikli zgjedhor ndikon në kapacitetin e qeverisë për të mbajtur premtimet e saj. Krahas reformave që tashmë janë "në proces", fillimi i një mandati favorizon realizimin e premtimeve, sepse legjitimiteti i mandatit demokratik që rrjedh nga zgjedhjet është veçanërisht i fortë në këtë kohë.

Nga analizat kërkimore për qeveritë e mandatura në dy dekadat e fundit na tregojnë për një nivel më të madh të aktivitetit dhe kapacitetit qeveritar për të zbatuar reforma në muajt pas marrjes së pushtetit, kohë në të cilën duket se energjia dhe pozitiviteti i

² <https://polifakt.al/publikime/trajnime/>

kabinetit të ndryshuar të qeverisë së re favorizohen nga një karikim i konsiderueshëm politik.

Por pikërisht analiza na tregon gjithashtu drejt një rënie të popullaritetit të qeverive me kalimin e kohës, gjë që redukton kapacitetin politik të qeverisë për të mbajtur premtimet e saj.

Një nga arsytet e kësaj rënie të popullaritetit qëndron në zbatimin e vullnetit të mandatit qeverisës, i cili ndeshet me formë të rezistencës ndaj ndryshimeve të dëshiruara/pritshme nga qytetarët, të cilat gjenden si brenda partisë, por po ashtu edhe brenda administratës publike.

Kjo rezistencë mund të marrë formën e rezistencave të heshtura në formën e mosbindjes ndaj detyrave publike, betejave mediatike, kundërshtive sektoriale ose lëvizjeve politike.

Në çdo rast, arsyeja pse vlen monitorimi dhe matja e përgjegjshmërisë së përmbushjes së premtimeve vlen për jurinë e madhe popullore (*qofshin qytetarë në tërësi apo një "publik i përzier nga rryma ideologjike, politike apo sociale"*).

Analizat deri më sot na tregojnë se prania e kapaciteteve institucionale dhe politike për të mbajtur fjalën/premtimin nuk garanton që premtimet do të respektohen.

Nxitja për të mbajtur disa premtime është e brendshme (në lidhje me politikën), për shembull, kur kandidati ose partia e tyre mbron një masë për arsye ideologjike.

Ndërkohë, sot ideologjia në një masë të madhe është bërë më pranë pragmatizmit duke bërë premtime që janë më të rëndësishme se të tjerat, për votuesin, si dhe për ardhshmërinë e partisë në vend të ideologjisë së bazuar mbi parime tradicionale.

Programet politike nën këtë qasje krijohen për të mbuluar shumicën e fushave të veprimit publik, por jo çdo fushë merr të njëjtin nivel vëmendjeje, gjë që domosdoshmërisht prodhon pritshmëri të ndryshme.

Në përgjithësi, premtimet që janë në qendër të projektit politik të partisë kanë më shumë shanse të mbahen dhe të arrijnë të përmbushen.

Stimujt për përmbushjen e zotimeve zgjedhore mund të lidhen edhe me strategjitë zgjedhore të pushtetit ekzekutiv (kërkimi i votave).

Respektimi i premtimeve të dikujt mund të bëjë të mundur bashkimin dhe mobilizimin e bazave elektorale dhe partiake, ose ndërtimin e besnikërisë me një bazë elektorale të njohur si favorizuese për kampin e partisë, por mbështetja e së cilës duhet të forcohet. Në të njëjtën kohë, mbajtja e disa zotimeve ndonjëherë mund të frenojë partitë opozitare, nëse ato janë të ndara në këtë çështje.

Ndërkohë, karakteristikat e publikut janë një parametër potencialisht vendimtar për respektimin ose jo të zotimeve elektorale. Nga njëra anë, publiku më me ndikim mund të zotërojë burime të mjaftueshme për të shprehur kërkesat e tyre dhe për t'i kujtuar me zë ekzekutivit angazhimet e tyre elektorale, apo edhe për të kontribuar vetë në përcaktimin e problemeve dhe zgjidhjeve.

Ne e kemi përmendur tashmë këtë ndikim sa i përket kapacitetit të përfaqësuesve të zgjedhur për të mbajtur premtimet e tyre.

Nga ana tjetër, pozicionet e politikave mund të bëhen prioritete për veprimin e qeverisë nëse grupet që do të përfitonin përbëjnë një pjesë strategjike të rëndësishme të elektoratit dhe shikohen pozitivisht nga shoqëria.

Nëse ato shihen pozitivisht, publiku që është më pak i mobilizuar dhe që nuk përbën një popullsi të synuar, bëhet objekt i politikave simbolike që lejojnë qeverinë të tregojë se kujdeset, por pa pasur nevojë të angazhojë burime.

Stimujt për të bërë dhe mbajtur premtime mund të jenë pjesë e një strategjie që synon marrjen e pushtetit, veçanërisht në ndërtimin e një shumice parlamentare dhe një koalicioni (qëllimi për të hyrë në detyrë).

Programet zgjedhore/ Manifestet nuk rrjedhin ekskluzivisht nga propozime që korrespondojnë me qëndrimin e përfaqësuar nga Kryetari i partisë (ose Kryeministri), por janë gjithashtu rezultat i kompromiseve të shumta, veçanërisht brenda partisë dhe me partnerët e mundshëm të koalicionit.

Nga ky këndvështrim, origjina e premtimeve në manifeste/programe duhet të ketë një ndikim në fatin e tyre, pasi qeveritë mund të ndjehen më pak të detyruara të respektojnë angazhimet e bëra pa dëshirë, si rezultat i lëshimeve ndaj grupeve minoritare në partinë e tyre ose ndaj partive në koalicion.

Qeveritë përballen me shumë presione konkurruese në aftësinë e tyre për të zbatuar politikatat. Realiteti i politikëbërjes është se qeveritë nuk i arrijnë të gjitha qëllimet e tyre gjatë kohës në detyrë.

Madje nëse shohim katër qeveritë e fundit në Shqipëri (2009 – 2025) ato me zorr arrijnë të përmbushin deri në [gjysmën](#) e zotimeve të tyre, një fakt që votuesit e dinë.

Për të bërë zgjedhje kuptimplote kur qeveritë kuptohet se nuk kanë gjasa të përmbushin të gjithë programin e tyre, votuesit duhet të dinë se cilat premtime kanë patur përparësi mbi të tjerat.

Pra, votuesit duhet të kuptojnë se cilat premtime në fakt kanë qenë dhe janë thelbësore për ofertën e një partie.

Rrjedhimisht, thyerja e premtimeve që perceptohen si të rëndësishme për platformën zgjedhore të një partie duhet kuptuar si një kërcënim mbi procesin demokratik.

Ky moment i të kuptuarit të pandershmërisë politike vlen më shumë sesa thyerja e premtimeve që shihen si kalimtare, sepse votuesit në fakt përballen me një hendek më të madh midis pritshmërive të tyre se çfarë do të ndodhë nëse partia votohet dhe krijon qeveri të re dhe asaj që ndodh në të vërtetë.

Një qeveri që përmbush vetëm disa nga premtimet e saj dhe nuk i përafuron në mënyrë të përsosur qëllimet e saj me atë që besonin votuesit.

Por, ajo do të konsiderohet ende se ka performuar mirë, pasi rrethanat e një mjedisi të pandershem politik dhe mediatik e bëjnë përsëri kandidatë për qeverisje, pasi shfrytëzohet edhe topitja dhe mbajtja në një numër në rritje një elektorat të paangazhuar dhe që kënaqet edhe me pak arritje.

Prandaj, kjo teori nënkupton që një sistem politik me parti të ndershme, një media informative të paanshme dhe shoqëri civile luftarake dhe kritike, si dhe një elektorat i vëmendshëm dhe i mirë informuar dhe i ditur është premisa për përfaqësimin premtues dhe demokracinë në përgjithësi.

Nëse ka arritur që të egzistojë ky ambjent politik, atëherë mund të konsiderohet realiteti se partitë kanë një detyrë morale që t'u komunikojnë qartë politikat dhe prioritetet e tyre votuesve.

Nëse një parti do t'i deklaronte prioritetet e saj në një manifest, por do të bënte fushatë publike për çështje që nuk planifikonte t'i përfshinte si prioritet nëse do të qeverisë, atëherë ajo do të ishte shumë fajtores për arritjen e një përfaqësimi të ulët premtues në qeveri.

Në të kundërt, një parti e cila bëri përpjekjet më të mira për të komunikuar prioritetet e saj, por dështon ta bëjë këtë për shkak se media vazhdimisht e keq karakterizon pozicionin dhe prioritetet e saj, kjo nuk e bën detyrimisht fajtorë për dështimin e saj për të arritur përfaqësimin e premtimit, pasi mediat do të duhet të ndajnë një pjesë të madhe të fajit për mungesën e përfaqësimit të premtuesit.

RËNDËSIA E DEBATIT POLITIK MBI PREMTIMET BAZUAR TE KOSTOJA E TYRE

Premtimi përbën vetë parimin e moralit, deri në atë masë që nuk do të kishte "etikë pa premtimin". Premtimi është, në veçanti, themelor për demokracinë, ku funksionimi i demokracisë përfaqësuese është ndërtuar efektivisht mbi lidhjen midis zotimeve elektorale dhe politikave qeveritare. Akti i përcaktimit të politikave alternative për t'u paraqitur në votim, i ndjekur nga miratimi i këtyre politikave nga përfaqësuesit e zgjedhur në formën e politikave aktuale publike, janë thelbësore për legjitimitetin e sistemeve demokratike përfaqësuese.

Në këtë kontekst, përfaqësuesit e partive politike konsiderohen të përgjegjshëm dhe duhet të mbajnë pasojat për premtimet e tyre përpara atyre që i zgjedhën.

[Ky parim](#) është i lidhur ngushtë me atë të "mandatit" që qytetarët u japin përfaqësuesve të tyre për të përmbushur një mision të përcaktuar.

Premtimet elektorale u paraqiten qytetarëve si një mjet për kontroll të vërtetë mbi vendimet politike që do të vijnë, dhe kështu ngjallin shpresa të mëdha, dhe përkatësisht zhgënjim ekstrem kur ato nuk mbahen, ashtu si ka ndodhur për gjithë periudhën e tre dekadave të fundit me modelin demokratik të zbatuar deri më sot nga politikanët.

Duke përfshirë në debatet politike edhe koston ekonomike të premtimeve zgjedhore, është një ofertë për publikun për tu qartësuar gjykimin e tyre mbi platformën politike duke ndikuar edhe partitë politike për një mundësi për të menduar dhe përmirësuar propozimet e tyre të politikave përpara se t'i publikojnë dhe deklarojnë ato.

Në këtë përvojë të re nevojitet që gjithashtu partitë politike (kryesisht për partitë opozitare) të kryejnë konsultime me analistët dhe ekspertët ekonomikë për të sistemuar dhe adresuar në mënyrë më të qartë financiare.

Kostoja e platformave zgjedhore të partive politike është ende relativisht e rrallë dhe duket se operon vetëm në pak vende të OECD-së.

POLIFAKT.al

ALTAX

PËRSOMËRIA NGA PËRVOJA E ZGJUAR

**SHKARKONI
FALAS
APP**



Ne publikojmë dhe shpërndajmë informacione, analiza dhe studime në vijimësi. Nëse komunikoni përmes adresave të mediave sociale apo nëse shkarkoni Aplikacionin, JU jeni vendosur në fokusin tonë dhe ne jemi në vëmendjen tuaj duke krijuar së bashku Një marrëdhënie mbi të përbashkëtat që na bashkojnë në jetën e përditshme.